



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT
të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës
së Prishtinës, mbajtur më 24.1.2012, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Mungoi: Engin Beyoglu (me leje).

Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues.

Kryesuesi i informoi të pranishmit se me kërkesën e Kryetarit të Komunës, për shkak të disa paqartësive dhe rrethanave të reja, hiqet nga rendi i ditës pika e tretë, duke dhënë edhe sqarime lidhur me këtë.

Aziz Pacolli përshëndeti iniciativën për kompensimin e pronës së paluajtshme dhe propozoi që kompensimi të mos jetë vetëm për një propozim, por të kompensohen të gjitha lëndët të cilat i kanë plotësuar kushtet për këtë. Njëherësh përkrahu edhe heqjen e pikës së tretë nga rendi i ditës.

Shemsi Veseli tha se nuk duhet të mbetet vakum për këtë çështje, por prona që jepet në shfrytëzim çdo herë të legalizohet me dokumentacione faktike, foto etj.

Hazir Borovci propozoi që në pikën “të ndryshme”, të trajtohet çështja e 52 pronave në lagjen “Kodra e Diellit”, për të cilat janë materialet. Është e drejtë dhe e ligjshme që kjo çështje të trajtohet.

Kryesuesi tha se këto kërkesa janë të arsyeshme, por kjo lëndë nuk është e vetmja, pra ka edhe të tjera që duhet të shqyrtohen. Njëherësh paraqiti edhe sqarime, duke thënë se dokumentacioni lidhur me to duhet të plotësohet.

Shefqet Sylejmani shtoi se po që se do të shqyrtohej pika e tretë, ne do të votonim kundër, sepse duhet të jetë e kompletuar me parcela dhe të dhëna të tjera, andaj e përkrah këtë iniciativë që ajo të plotësohet me të dhëna shtesë.

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dymbëdhjetë;
2. Propozimrregullorja për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë “Auto - Taxi”;
3. Propozimvendimi për zgjatjen e afatit të dhënies së pronave komunale në shfrytëzim;
4. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qendrës së Mjekësisë Urgjente;
5. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;
6. Të ndryshme.

Pika e parë

Mustafë Krasniqi bëri vërejtje në pikën e tretë të ekstraktit të procesverbalit, duke thënë se nuk qëndron ajo që është shkruar në ekstrakt, andaj duhet të jetë “... nuk e kemi përkrahur që të bëhet germimi dhe mbushja e asaj rruge, por kërkuam që të bëhen zgjidhje tjera”.

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dymbëdhjetë, me vërejtjen e dhënë.

Pika e dytë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Agim Salihu**.

Shefqet Sylejmani tha se është mirë që ne po e plotësojmë një rregullore të mëparshme, ku shihet një qasje e thukët dhe e qartë. Në nenin 4 në vend të “që kanë së paku 4 dyer”, të jetë “me katër dyer”. Në nenin 7, pika 2, të sqarohet pjesa “5 vjet nga dita e skadimi të ndalesës”. Në nenin 8, shkronja e të definohet më qartë, gjithashtu të sqarohet edhe neni 8.2. Në nenin 14, shkronja b “të ketë së paku 4 dyer”, të veprohet si më lartë dhe të qartësohet kuptimi i formulimit nën shkronjën c. Në shkronjën I “...duhet të jenë të ngjyrosura me ngjyrë të njëjtë”, të mbetet, por për t’i kursyer nga shpenzimet, propozoi që ky shpenzim t’iu zbritet nga taksa. Në nenin 23 në vend të “...me hyrjen e udhëtarit në automjet”, të jetë “në momentin e nisjes”. Në nenin 25 në vend të “...detyrohet”, të jetë “është i detyruar”. E njëjta gjë vlen edhe më poshtë, gjegjësisht në pikën 2 dhe 3. Në vend të “...ndërresa pa mëngë”, të jetë “...me mëngë të shkurtra”. Nenet 27. 2 dhe 28.2 të qartësohen më mirë. Neni 29 të qartësohet, në mënyrë që të ndërmerren masa.

Shemsi Veseli bëri vërejtje në nenin 6, ku thuhet “Transportin taksi të udhëtarëve mund ta ushtrojnë personat fizikë, të cilët këtë e kanë profesion të vetëm”, kjo duhet plotësuar, sepse edhe personat e tjerë mund ta ushtrojnë këtë veprimtari. Gjithashtu duhet të plotësohet edhe neni 14. Ai tha se nuk kemi informacione se a është biseduar edhe me Shoqatën e auto-taksistëve dhe nëse janë bërë bisedime, të thuhet se cilat janë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Ka persona që punojnë edhe diku tjetër dhe se auto-taksin e kanë “hobi”, andaj kushtet dhe kriteret duhet të respektohen në mënyrë të përpiktë. Urojë që kjo rregullore të zbatohet!

Tefik Mehmeti dha disa sugjerime dhe shtoi se në nenin 4, ku thuhet që *transporti i udhëtarëve mund të kryhet vetëm me automjet me 5 ulëse*, të parashihet mundësia që ai të ketë edhe më shumë ulëse. Në nenin 7, shkronja c, “... të jetë banor i komunës së Prishtinës” përsëritet, andaj kjo duhet rregulluar. Propozoi që çështja e pushimeve vjetore dhe mjekësore të jenë në një pikë dhe të parashihen sipas ligjit në fuqi. Në nenin 14, të shtohet edhe një pikë, ku do të parashihej vjetërsia e automjetit. Në nenin 15, shkronja a të shtohet “me marrëveshje të dëshmuar me shkrim”. Në nenin 26, pika 4, të shtohet “me dhënien e faturës”.

Aziz Pacolli propozoi që automjetet që do të shërbejnë për auto-taksi, të kenë së paku katër dyer dhe të mos ndalen në stacion të autobusëve, njëherësh uroi që kjo rregullore të zbatohet.

Kryesuesi tha se duhet sqaruar nenet për të cilat u kërkuan sqarime. Kjo rregullore, për të cilën kemi pas shumë nevojë, është hartuar në bashkëpunim me Shoqatën e auto-taksistëve.

Agim Salihu paraqiti sqarime shtesë.

U konstatua se u përkrah Propozimrregullorja për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë “Auto-Taksi”, me ndryshime dhe plotësime dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tretë

Arsyetimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti **Agim Salihu**.

Kryesuesi insistoi që të shqyrtohet me kujdes, në mënyrë që përfituesit e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale të mos e kenë bartur këtë te personat e tretë, por nëse e kanë bërë një gjë të tillë, kjo e drejtë t’iu merret, e gjithashtu të vepohet edhe me ata të cilët nuk i kanë kryer obligimet komunale.

Shemsi Veseli përkrahu mendimin e kryesuesit sa i përket bartjes së të drejtës në shfrytëzim të pronës komunale dhe pagimin e taksave, por bëri vërejtje në preambulë, ku nuk është dhënë arsyetimi si duhet. Aty duhet të ceket edhe Ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, i miratuar në vitin 2010, si dhe të qëndrojnë edhe obligimet që kanë këta shfrytëzues ndaj Komunës. Për mbledhjen e Kuvendit kërkoi që t’iu ofrohet edhe ndonjë mostër e kontratës. Ai u shpreh kundër vazhdimit të afatit për disa përfitues, të cilët e shfrytëzojnë atë pronë vetëm për përfitime të veta, siç është KF “Prishtina”, “Don Bosko” etj. Afati për 10 vjet për shfrytëzim është shumë i madh. Në KF “Prishtina” ka edhe konflikt interesi, pasi që një pjesë të aksioneve të këtij klubi janë të djalit të kryetarit të Komunës, andaj kërkoi që të specifikohet shumë

drejtë se çka është interesi i Komunës. Ligji në fuqi nuk lejon vetëm vazhdimin e kontratave, por për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim duhet të shpallet tender, andaj jam kundër vazhdimin të kontratave në këtë mënyrë.

Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë lidhur me akuzën për konflikt interesi dhe për vazhdimin e kontratave të përfituesve të propozuar.

Shefqet Sylejmani përkrahu një pjesë të sugjerimeve të kryesuesit dhe të Shemsi Veselit, por me pjesën e diskutimit të z. Veselit dhe konstatimin e tij se ka konflikt interesi në mes të kryetarit të Komunës dhe stadiumit të KF "Prishtina", nuk mund të pajtohem, sepse të qenit aksionar biri i kryetarit në këtë klub daton shumë më herët se të qenit kryetar i komunës z. Isa Mustafa. Duhet të jemi të kujdesshëm në perceptimin e vërtet të konfliktit të interesit dhe spekulimeve për konflikt interesi. Nga ana tjetër, dihet se të gjitha vendimet merren nga Kuvendi, pjesë e të cilit jemi edhe ne. Ai gjithashtu pyeti se a janë të gjitha ato parcela të Komunës së Prishtinës që ju skadon afati i kontratës. Ne nuk mund të dimë se ku janë këto parcela, andaj të sqarohen mirë parcelat dhe zonat dhe t'i kemi në dispozicion edhe fotografitë. Propozoi që me sugjerimet e dhëna, materiali të dërgohet për miratim në Kuvend.

Kryesuesi tha se pika e shtatë "Bijat e Dashurisë së Krishterë" nuk korrespondon si duhet, andaj duhet të sqarohet dhe përcaktohet.

Aziz Pacolli shtoi se atyre që e kanë keqpërdorur këtë të drejtë dhe iu ka skaduar kontrata, përveç KF "Prishtina", afati i vazhdimin të kontratës t'iu caktohet për 5 vjet. Ai gjithashtu shtroi pyetjen edhe lidhur me lokalet për qark stadiumit se a e kanë të rregulluar këtë çështje.

Kryesuesi paraqiti sqarimet e nevojshme lidhur me pyetjen e parashtruar, njëherësh tha se duhet shikuar se a është profitabile veprimtaria e qendrës për aftësimin profesional "Don Bosko".

Tefik Mehmeti tha se nëse kemi të bëjmë me vazhdimin e kontratës, atëherë është në rregull, por nëse është kontratë e re, atëherë duhet të zbatohet ligji dhe të definohet se prona nuk mund të tjetërsohet, ndërkaq sa i përket QAP "Don Bosko", duhet të shikohet, por nuk di që është profitabile.

Agim Salihu paraqiti sqarime shtesë.

U konstatua se me shumicë votash, me një votë kundër, u përkrah Propozimvendimi për zgjatjen e afatit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, me ndryshime dhe plotësime, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt dhe e pestë

Agim Salihu paraqiti arsyetimin lidhur me këto dy pika të rendit të ditës.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qendrës së Mjekësisë Urgjente dhe Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë Të ndryshme

Shefqet Sylejmani ripërsëriti kërkesën përkitazi me lagjen “Tophane” dhe kërkoi nga Drejtoria e Inspektionit të ndërmarrë masat e nevojshme për largimin e kamionëve, traktorëve dhe punëtorëve të krahut nga kjo lagje. Ai gjithashtu luti kryesuesin që, në kuadër të kompetencave të veta, të ndikojë në përshpejtimin e punës së Komisionit për pranimin teknik dhe lejes së përdorimit, në mënyrë që të përcaktohet se cila është prona e Komunës në kompleksin banesor në lagjen “Kodra e Diellit”. Kërkoi nga kryesuesi dhe Këshilli i Drejtorëve që të mendojnë për një ide për caktimin e lokacionit për varrezat e qytetarëve me merita të veçanta, pasi që në Varrezat e Dëshmorëve po varrosen edhe personat që nuk e kanë këtë thirrje, andaj është nevojë e kohës që kjo të bëhet. Ai gjithashtu luti që informimi dhe ftesat që iu drejtohen përfaqësuesve të subjekteve politike në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, të bëhen saktë dhe me kohë, në mënyrë që të jemi prezent me rastin e përrurimeve, takimeve dhe mbledhjeve të ndryshme, pasi që po ndodhë shpesh që ato t’i marrim në momentin e fundit. Nuk kemi të bëjmë me bojkot, por ato duhet marrë me kohë.

Kryesuesi paraqiti sqarime dhe u përgjigj në pyetjet e parashtruara.

Behxhet Musliu dha disa sqarime përkitazi me pengesat e paraqitura rreth kompleksit banesor në lagjen “Kodra e Diellit”.

Shefqet Sylejmani shtoi se janë të njoftuar përkitazi me problemet, por kërkoi që puna e komisionit të përshpejtohet.

Milazim Vitia tha se ka qenë pak skeptik lidhur me pastrimin e rrugëve. Në këtë drejtim është bërë punë e madhe, por ndërmarrja duhet të ndihmohet, në mënyrë që të jetë më azhure dhe punët të kryhen më shpejt.

Kryesuesi paraqiti sqarime përkitazi me punët e bëra në pastrimin e rrugëve.

Shemsi Veseli shtoi se rrugët kanë qenë në gjendje të tmerrshme, por duhet të pasur kujdes gjatë dhënies së tenderëve, të shikohet se kujt po i jepen dhe a do të mund t’i përmbushin detyrimet. Ai gjithashtu tha se ka qenë një komision që ka bërë shikimin se a po shfrytëzohen apo jo banesat nga përfituesit e tyre në kompleksin banesor në lagjen “Kodra e Diellit”. Në këtë kompleks ka banesa të cilat janë të mbyllura dhe fare nuk shfrytëzohen nga përfituesit. Jam dëshmitar i keqpërdorimeve që po bëhen aty, andaj kjo çështje duhet të ndërpritet. Nuk shoh informatë prej komisionit. Kam insistuar, gjë që na bën nder, që një nga këto banesa t’i ndahet Adem Demaçit.

Nga Drejtoria e Arsimit kërkoi informatë lidhur me përfundimin e gjysmëvjetorit të parë, si dhe kërkoi që të definohet prona përballë Kuvendit, e cila po shfrytëzohet për parking, a ka kontratë dhe, nëse jo, pse tolerohet një gjë e tillë.

Tefik Mehmeti paraqiti ankesën e banorëve të Bashkësisë XV lokale, ku nëpunësi i kësaj bashkësie ka treguar sjellje jo të mira me qytetarët në kuptim të asaj se për një vërtetim kërkon administratë të tepruar, si dhe për vulosjen e dokumentacionit që e lëshon kjo duhet bërë në Komunë, andaj ato kompetenca duhet të hiqen. Përkitazi me pastrimin tha se është më mirë se në vitin e kaluar dhe se qytetarët duhet të jenë më të ndërgjegjshëm dhe trotuaret duhet pastruar individualisht.

Kryesuesi paraqiti sqarime lidhur me pastrimin dhe shtoi se ka ndihmesë edhe nga Komuna.

Behxhet Musliu dha sqarime lidhur me punën e komisionit dhe kompetencat e tij.

Mbledhja mbaroi në orën 17:40.

PROCESMBAJTËSJA:

Alije Gusia

KRYESUESI I KOMITETIT

Sami Hamiti, ecc. i dipl.